



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, javën e kaluar Trupi Gjykses caktoi rendin e ditës për deklaratat përmbyllëse, të cilat tani janë caktuar të mbahen nga 15 deri 18 prill 2024.

Sipas rendit të ditës aktual, i cili mund të ndryshojë, Prokuroria do të mbajë deklaratën përmbyllëse më 15 dhe 16 prill, pasuar nga deklarata e Mbrojtësit të Viktimave më 16 prill, dhe deklarata përmbyllëse e Mbrojtjes së z. Shala më 16 dhe 17 prill.

Në vijim, përgjigjet e palëve ndaj njëra-tjetrës, komentet, dhe pyetjet nga gjykatësit do të mbahen më 17 dhe 18 prill. Gjykatësit kanë caktuar gjithashtu që deklaratat, përgjigjet dhe komentet në lidhje me aspektin e zhdëmtimit të mbahen më 17 dhe 18 prill.

Z. Shala ka shprehur dëshirën për të folur gjatë deklaratave përmbyllëse dhe Trupi Gjykses dha udhëzim që ai të japë deklaratën e vet pasi palët dhe Mbrojtësi i Viktimave të kenë përfunduar parashtrimet e tyre.

Sipas Rregullores së Procedurës dhe të Provave, pas deklaratave përmbyllëse, Kryegjykatësi e shpall çështjen gjyqësore të mbyllur. Në këtë fazë, Trupit Gjykses nuk mund t'i paraqitet asnjë parashtrim tjetër dhe Trupi Gjykses nuk mund të pranojë asnjë parashtrim apo të dëgjojë prova të tjera, përveçse në rrethana të veçanta.

Pas mbylljes së çështjes gjyqësore, gjykatësit e Trupit Gjykses kuvendojnë konfidencialisht, për të nxjerrë vendim në lidhje me akuzat në aktakuzë. Aktgjykimi shpallet nëntëdhjetë ditë pas mbylljes së çështjes gjyqësore, përveç nëse rrethanat kërkojnë zgjatje të mëtejshme të afatit.

Ju lutemi vini re se aktualisht nuk është planifikuar të mbahet seancë më 19 prill, përveç nëse urdhërohet ndryshe.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, dëshmitari i 54-t i thirrur nga Prokuroria filloi dhënien e dëshmisë të martën. Ky është dëshmitar i mbrojtur, dëshmia e të cilit u mbajt plotësisht në seancë të mbyllur, sipas urdhrit të Trupit Gjykses për mbrojtjen e dëshmitarit.

Të mërkurën, Shon Bërns (Shaun Byrnes) vazhdoi dhënien e dëshmisë nga java e kaluar. Z. Bërns ishte shef i Misionit Amerikan të Vëzhguesve Diplomatikë në Kosovë nga gushti 1998 deri në korrik 1999. Po atë ditë më vonë, dëshmitari i 54-t u kthye në sallë të gjyqit dhe vazhdoi dhënien e dëshmisë dje dhe sot.





Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 28 mars, Trupi Gjykues miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Selimit dhe zgjati afatin për paraqitje të përgjigjeve ndaj parashtimeve të Prokurorisë të listave të dëshmitarëve dhe mocionit për praninë të provave të dëshmitarëve.

Seanca e ardhshme në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar të mbahet më 22 prill, në orën 09:00 paradite.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

